

UDHËZIM
Nr. 4, datë 9.9.2020

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 3606/2 (18), DATË 28.10.2011 “PËR
PAJISJEN E PËRDORUESVE TË MJETEVE RRUGORE TË KATEGORIVE C, CE, D
DHE DE, ME CERTIFIKATËN E AFTËSIMIT PROFESIONAL (CAP)”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të pikave 7 dhe 8, të nenit 115/1, të nenit 224, të Kodit Rrugor të Republikës Shqipërisë dhe të nenit 294 dhe 296, të vendimit nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë,

UDHËZON:

1. Në fund të nenit 27 shtohet paragrafi, si më poshtë:

“Afati i vlefshmërisë së CAP, për kategorinë e drejtuesve, pa iu nënshtruar kualifikimit dhe pa testim, të cilëve u referohet neni 25, zgjatet deri në përfundim të vlefshmërisë së kategorisë respektive të lejedrejtimit, por jo më vonë se data 20.10.2022.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku